

## AKT THEMELIMI

Ky akt themelimi perpilohet nga ortaku:

**EJUP SULA**, l biri i Bardhylit, dtl.30.07.1969, lindur e banues ne Elbasan, Lagja "Sul Misiri", mbajtes i leternjoftimit ID Nr.027906415, Nr.personal G90730004L, leshuar me 20.11.2009i cili me vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me ligjin nr.9901 date date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ndryshuar me Ligjin nr.129/2014, date 02.10.2014, si dhe me aktet e tjera te legjislacionit shqiptar qe trajtojne keto ceshtje, ka krijuar shoqerine : "ID SYDEX" SHPK.

### N E N I 1

Shoqeria vepron ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe ne perputhje me dispozitat e Statutit qe i bashkengjitet ketij akti.

### N E N I 2

Emri i shoqerise do te jete "ID SYDEX" SHPK.

### N E N I 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :

**"Prodhimin, tregtimin me shumice dhe pakice te lendeve plastike, prodhimin dhe tregtimin me shumice dhe pakice te detergjenteve per perdorim familjar, professional, industrial, horeca dhe te produkteve kozmetike, prodhim, perpunim, demineralizim, trajtim antibakterial dhe tregtim te ujit per industrine e prodhimit te detergjenteve, asaj ushqimore, shendetsore dhe metalmekanike, krijimin e linjave te ndryshme prodhuese, kryerjen e veprimtarive ndertimore, instalimin e impianteve te ndryshme hidraulike, te pastrimit, higjenizimit dhe tregtim te tyre, import-ekport te produkteve kimike, detergjenteve, te lendeve te para per detergjente dhe derivateve te tyre, studime tregjesh dhe sondazhe opinionesh, menaxhim i parqeve, ambienteve dhe zonave te mbrojtura natyrore, menaxhim te strukturave hoteliere dhe sportive, ushtrim i aktivitetit dhe menaxhimit te zonave te mbrojtura natyrore dhe gjuetise sportive, transporti i mallrave, konsulence teknike dhe project management".**

Pervec veprimtarive te parashikuara me lart, ne veprimtarine sipermarrrese te shoqerise do te hyje cdo veprimtari tjetër industriale, tregtare, financiare, kryerja e operacioneve ekonomike e juridike, industriale, prodhuese, tregtare qe lidhen drejt per drejt ose terthorazi me objektin e veprimtarise se shoqerise, brenda kuadrit te dispozitave ligjore per realizimin e cdo biznesi te pershtatshem per arritjen e qellimit te shoqerise.



#### N E N I 4

Selia e Shoqerise ndodhet ne Elbasan, ish-Kombinati Metalurgjik, Uzina 12, nr.10.

Me vendim te ortakut, selia mund te ndryshohet.

Adresa elektronike e shoqerise do te jete : info@idsidex.com

#### N E N I 5

Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj si ne territorin e Republikes se Shqiperise ashtu edhe jashte saj. Shoqeria mund te krijojë dege (filiale) ose perfaqesi, si ne rrethe te ndryshme te Republikes se Shqiperise, ne nje nga menytrat e parashikuara ne legjislacionin shqiptar ne fuqi, ashtu edhe ne shtete te tjera, ne perputhje me legjislacionin e vendeve perkatese.

#### N E N I 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 (njqindmije) leke dhe perbehet nga kontributi I meposhtem:

Z.Ejup Sula ka derdhur shumen prej 100 000 (njqindmije) leke, I cili zoteron nje kuote te vetme me vlere nominale 100 000 (njqindmijemije) leke.

#### N E N I 7

Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje afat kohor te pacaktuar.

#### N E N I 8

Si organ I vetem drejtues I Shoqerise eshte ortakut I vetem, me iniciativen dhe kapitalin e te cilit vepron Shoqeria.

#### N E N I 9

Administrator I shoqerise do te jete **Z.Ejup Sula**, emerimi I te cilit behet per nje afat prej 5 (pese) vitesh financiare, me te drejte perseritjeje.

#### N E N I 10

##### **Zgjidhja e mosmarrveshjeve**

Te gjitha mosmarrveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se Shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit do te paraqiten per zgjidhje Gjykates kompetente shqiptare.

**ORTAKU THEMELUES**





Nr. 1162 Rep

Elbasan me 01.12.2015

## VERTETIM

Ne Elbasan, sot ne date 01.12.2015 (nje dhjetor dymijepesembedhjete), ditën e Marte, perpara meje noteres Enkelejda M.Marinaj, me qender te veprimtarise ne Lagjen "5 Maj" te qytetit te Elbasanit, prane Gjykates se Rrethit Gjyqsor Elbasan, u paraqit personalisht:

**EJUP SULA**, I biri I dtl.30.07.1969, lindur e banues ne Elbasan, Lagja "Sul Misiri", madhor, me zotesi te plote per te vperuar, identifikuar nepermjet leternjoftimit ID Nr.027906415, Nr.personal G90730004L, leshuar me 20.11.2009, I cili pasi deklaroi se Statuti I shoqerise "ID SYDEX" SHPK (gjithsej dy flete), eshte hartuar prej tij me vullnet te lire, e nenshkroi ne pranine time noteres.

Une noterja, bazuar edhe ne Ligjin 7829, date 01.06.1994 "Per Noterine", e vertetoj ate.

**NOTERE**

*Enkelejda M. Marinaj*